



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Doretzuar Priljenar / Prodato Received / Delivery	31.10.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtorca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	6596/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.752/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.752/2022 të datës 31.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "Transferim i përhershëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi me numër protokollit 5489 i datës 02.08.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën 1 të dispozitivit, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 31.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5045/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.752/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 10242 të datës 22.12.2020, dhe Vendimit me



numër 5489 të datës 02.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me pretendimin ankimor për shkelje të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe infrastrukturës, ndërsa me datë 14.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, sipas kërkesës se kolegjit me datën 12.10.2022, me Vendimin VK.nr.117/2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me këtë çështje juridiko-administrative edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 5045/2022 të datës 31.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses me numër Nr.Prot.10765 të datës 16.11.2018; Raportin mjekësor te datës 21.12.2020 për ankuesen; Kërkesën e ankueses lidhur me realizimin e pushimit të lehonisë për periudhën prej 21.12.2020-21.09.2021; E-mailat zyrtar të datës 23.12.2020; Vendimin Nr.prot.10312 të datës 24.12.2020 lidhur me pushimin e lehonisë për ankuesen; Vendimin Nr.prot.10242 të datës 22.12.2020 lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit; Vendimin Nr.Prot.5489 të datës 02.08.2022 lidhur me transferimin e ankueses; Formularët e certifikimit të datës 09.01.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 5149/22 të datës 05.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 5391/22 të datës 14.09.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe infrastrukturës se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses me numër AE.Nr.DIEKP/3/2022 te datës 02.08.2022; Vendimin me numër reference 07/1-01A/8207 të datës 15.11.2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 15.11.2018; Kërkesën për prova shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 24.10.2022 nga KPMSHCK për MMMPH-në; Përgjigjen në prova shtesë nga MMPH-ja përmes e-mailit zyrtar te datës 24.10.2022; Kërkesën për pushim pa pagesë të ankueses Nr.Prot.8625 të datës 11.10.2021 dhe Vendimin VK.nr.117/2022 të datës 12.10.2022 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës se ankueses në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët konstatoi se në këtë çështje juridiko-administrative janë plotësuar kushtet ligjore për kthimin e lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja nga data 16.11.2018 ka qenë e emëruar në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Të njëjtës me Vendimin me numër protokolli 10312 të datës 24.12.2020 i është aprovuar pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej nëntë (9) muajsh, duke filluar nga data 21.12.2020 deri me datë 21.09.2021. Po ashtu, sipas shkresave të lëndës, ankuesja me datë 11.10.2021 përmes shkresës me numër protokolli 8625 ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh dhe atë duke filluar nga data 25.09.2021 deri me datë 24.12.2021,



ndërsa me datë 06.12.2021 ankuesja përsëri ka parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh dhe atë nga data 24.12.2021 deri me datë 24.06.2022, e cila kërkesë është miratuar nga organi i punësimit, në kuptim të nenit 49 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pas përfundimit të pushimit pa pagesë, prej gjashtë (6) muajsh, ankuesja me Vendimin me numër protokolli 5489 të datës 02.08.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturës, është transferuar në pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Integritet Evropian në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave* dhe po ashtu të njëjtës me datë 02.08.2022 i është lëshuar edhe Akti i Emërimit me shifër AE.Nr.DIEKP/3/2022 për pozitën e njëjtë, të cilin akt emërim ankuesja e ka nënshkruar me "vërejtje".

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër protokolli 10242 i datës 22.12.2020, dhe Vendimi me numër 5489 i datës 02.08.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, janë nxjerrë përmes shkeljes së dispozitave të Ligjit për Zyrarët Publikë, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses në raport me Vendimin me numër protokolli 10242 të datës 22.12.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 127 ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrtojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, rrjedhimisht duke u mbështetur në përcaktimin ligjor të dhënë si në paragrafin 2 të nenit 127 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit konstatoi se pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti mund të parashtrtojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit.*

Andaj, duke marrë parasysh se vendimi i kontestuar me numër protokolli 10242 është nxjerrë me datë 22.12.2020, ndërsa ankuesja pretendon në paligjshmërinë e të njëjtit përmes ankesës së parashtruar me datë 31.08.2022, jashtë afatit prej gjashtë (6) muajsh nga momenti i nxjerrjes së aktit të kontestuar, respektivisht pas njëzet (20) muajsh nga dita e nxjerrjes së vendimit të kontestuar, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankueses në raport me Vendimin me numër protokolli 10242 të datës 12.12.2020 janë të palejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Ndërsa, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses në raport me Vendimin me numër protokollin 5489 të datës 02.08.2022, Kolegji i Këshillit analizozi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe rrjedhimisht duke ju referuar nenit 127 paragrafit 1 të këtij ligji konstatoi se pretendimet ankimore të ankueses në raport me këtë akt administrativ të kontestuar, janë të pranueshme në kuptim të afatshmërisë sepse Vendimi me numër protokollin 5489 është nxjerrë me datë 02.08.2022, ndërsa ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 31.08.2022, brenda afatit të përcaktuar ligjor prej tridhjetë (30) ditësh.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kontestuar me numër protokollin 5489/2022 të datës 02.08.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes të cilit vendim ankuesja është transferuar në pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Integritet Evropian në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave*, ka konstatuar se akti i ankimuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse pas përfundimit të periudhës së pezullimit në rast kur pozita e punës është plotësuar përfundimisht, nëpunësi civil transferohet sipas procedurës në përshtatshëri me procedurën e përcaktuar me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë. Pra, transferimi i nëpunësit civil miratohet nga njësia përgjegjëse, ku sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësia përgjegjëse në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është Njësia për Burime Njerëzore.

Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Rrjedhimisht, nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se vendimi i kontestuar me numër protokollin 5489/2022 i datës 02.08.2022 për transferimin e ankueses nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe po ashtu nuk është dhënë asnjë arsyetim nëse nëpunësja civile i plotëson kushtet për pozitën përkatëse të punës, gjegjësisht pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Integritet Evropian.

Për sa më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokollin 5489/2022 i datës 02.08.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është i kundërligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke qenë se vendimi i atakuar me numër protokollin 5489/2022 i datës 02.08.2022 përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda e ankueses të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi kompetent, në këtë rast Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtojë çështjen e transferit të përhershëm të ankueses dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.752/2022, datë 31.08.2022.

Ardita Perguku-Shyti

Procesmbajtëse



Jeton Koca

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.